



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 43

Tiranë – E mërkurë, 27 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 2304, datë 26.12.2017	Për shpalljen e një vendi vakant në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit 3

**KËRKESË****Nr. 2304, datë 26.12.2017****PËR SHPALLJEN E NJË VENDI
VAKANT NË KOMISIONIN E PAVARUR
TË KUALIFIKIMIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon shpalljen e një vendi vakant në datën 27.12.2017, me tekstin e mëposhtëm:

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, shpall vendin vakant për pozicionin:

1. Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit master i shkencave për Drejtësi;
- b) Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze;
- c) Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në nivel drejtues e menaxherial.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t'u pajisur me “certifikatë sigurie”, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidati duhet të ketë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afatet kohore të limituara.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 10.1.2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

a) Paraqitja e aplikantit, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPK-së, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–premtë, ora 09:00–16:00.

b) Kërkesë me shkrim dërguar me postë zyrtare, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10.1.2018, që vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar.

c) Kërkesë për aplikim nëpërmjet postës elektronike në adresën komisionipavarurikualifikimit@gmail.com, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

c) Dëshmi penaliteti;

d) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

e) Çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Ramadan Çaço

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.